



---

**VENDIM**  
**Nr.90 Datë 15.11.2010**

**PËR**  
**DENIMIN ME GJOBE TE CEZ SHPERNDARJE SH.A PER SHKELJET**  
**E KONSTATUARA LIDHUR ME MOSZBATIMIN NGA ANA E SAJ TE**  
**VENDIMEVE TE ERE-SE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 64 pika "ç" të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi denimin me gjobe të Cez Shperndarje sh.a. për shkeljet e konstatuara lidhur me moszbatimin nga ana e saj të vendimeve të ERE-së, si dhe u njoh me pretendimet e shoqërisë Cez Shpërndarja sh.a (prezent në mbledhje), të pasqyruara dhe në proces – verbalin bashkëlidhur këtij vendimi,

**Vendosi :**

- 1- Denimin me gjobe në shumën 350 000 leke të shoqërisë CEZ Shperndarje Sha, "Për moszbatim të kushteve të percaktuara në license dhe konkretisht të pikës 3.1, të Licenses për Aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike".
- 2- Të gjitha faturimet e kryera nga ana e CEZ Shperndarje Sh.a. ndaj klienteve familjare dhe jofamiljare, me emërtimin "Dem Ekonomik" apo "Energji e Pamatur" pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 9997, datë 22.09.2008, janë të paligjshme.
- 3- Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Cez Shpërndarjen për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

## KRYETARI I ERE-s

**Bujar  
NEPRAVIS  
HTA**